



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 30 Janar 2021

Nr: 19

VENDIM

PËR

SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMIT NR. 395 DATË 04.01.2021 PËR
SHKELJE TË PARASHIKUAR NË VENDIMIN NR. 9, DATË 24.12.2020, TË
KOMISIONIT RREGULLATOR NË KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE
NDAJ KRYEMINISTRISË

Në mbështetje të neneve 19, paragrafi 1, shkronja “n”, paragrafi 2, 78, pika 6, 91 e 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neneve 60 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve,

VËREN:

I

Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, është raportuar një denoncim nga Instituti i Studimeve Politike (ISP), në ndërfaqen e “Aktiviteteve të Ndaluara”, në rubrikën “Kallëzo”, për përdorimin e materialeve propagandistike statike. ISP raporton se në sfondin kryesor të portalit “Shqipëria që Duam” është përdorur një fotografi nga një miting elektorale të Partisë Socialiste ku ndodhen disa flamuj të këtij subjekti politik.

Sipas denoncimit, më datë 04.01.2021, me numër identifikimi të gjeneruar nga sistemi ID nr. 395 ora 20:12, pretendohet se: *“Portali zyrtar i qeverisë, Shqipëria që Duam, ka në sfondin kryesor një miting elektorale të Partisë Socialiste të Shqipërisë, me mbi 35 flamuj të këtij subjekti politik. Portali është denoncuar nga ISP në 2019 dhe KQZ është shprehur me rekomandim, për institucionet për ta hequr pasi foto kryesore e portalit ndodhet në çdo institucion zyrtar në Shqipëri, por asnjë institucion nuk e ka hequr. ISP ka komunikuar me kryeministrinë si institucioni prodhues i këtij portali, por pavarësisht se*



Data: 30 Janar 2021

Nr. 19

Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 395 datë 04.01.2021 për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj

përbën shkelje të Kodit Zgjedhor, institucioni nuk e ka ndryshuar me argumentin se kërkon kosto financiare prodhimi i mijëra banerave mbi portalin”.

Sipas përcaktimeve të nenit 44, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve shqyrtoi paraprakisht kërkesat lidhur me kompetencën e organit publik për shqyrtimin e tyre.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi denoncimin, në verifikimin paraprak të të dhënave, konstatoi se:

Referuar nenit 76, pika 1, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, “*Fushata Zgjedhore nis 30 ditë para datës së zgjedhjeve dhe përfundon 24 orë para datës së zgjedhjeve*”.

Referuar neni 78, pika 6, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”... *ndalohet zhvillimi i fushatës zgjedhore në institucionet publike...*”

Referuar nenit 79, pika 2, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, “...*përdorimi dhe afishimi i çdo materiali statik për propagandë zgjedhore, përfshirë flamujt dhe posterat, që i shërbejnë subjektit zgjedhor për promovimin e fushatës zgjedhore, lejohet vetëm në një largësi prej deri 5 metrash nga zyra zgjedhore e partisë politike apo subjektit zgjedhor përkatës*”.

Referuar nenit 79, pika 4, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar “*ndalohet përdorimi i materialeve propaganduese në kundërshtim me përcaktimet e bëra më sipër*”.

Në zbatim të dispozitave të mësipërme, raportimi i ISP, se në sfondin kryesor të portalit “Shqipëria që Duam” është përdorur një fotografi nga një miting elektorale i Partisë Socialiste ku ndodhen disa flamuj të këtij subjekti politik, nuk përbën veprimtari të ndaluar në kuptim të nenit 3 të vendimit nr. 09/2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Dispozitat e ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikojnë ndalimin e përdorimit të materialeve propagandistike, 30 ditë para datës së zgjedhjeve.

Bazuar në nenin 76, pika 1, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe në datën e dekretuar për zgjedhjet, fushata zgjedhore nis në datën 25.03.2021.



Referuar vendimit nr. 638, datë 6.11.2017, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e agjencisë për dialog dhe bashkëqeverisje”, Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje është krijuar si një institucion juridik, publik, në varësi të Kryeministrit dhe ka si mision ofrimin direkt të shërbimeve publike, për të garantuar bashkëqeverisje e gjithëpërfshirje në politikëbërje dhe vendimmarrje, nëpërmjet ndërveprimit në platformën elektronike “Me ty, për Shqipërinë që duam”.

Nga sa parashikohet në këtë vendim, Agjencia, ushtron funksionet e saj publike nëpërmjet ndërveprimit në platformë. Në kuptim të nenit 7 të vendimit nr.9/2020 të Komisionit Rregullator duhet të jetë e kujdesshme në përmbushjen e detyrave të veta ligjore duke i ndarë ato qartazi nga veprimtaria e subjekteve politike.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të neneve 19, paragrafi 1, shkronja “n”, paragrafi 2, 78, pika 6, 91 e 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 22 e vijues dhe 60 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve,

V E N D O S:

1. Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje, institucion juridik, publik, në varësi të Kryeministrit, të marrë masat e nevojshme për heqjen e materialeve propagandistike (flamuj të subjektit politik Partia Socialiste) nga platforma elektronike nëpërmjet së cilës ajo ushtron funksionet e veta.
2. Të njoftohet Kryeministria dhe Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje për zbatimin e këtij vendimi.
3. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen me postë elektronike denoncuesit.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

